



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 3, datë 24.01.2022

MBI

**“SHPLLJEN E E ZGJEDHJEVE TË REJA PËR ANËTARË TË KOMISIONIT  
INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE SI DHE HAPJA E PROCEDURAVE PËR  
APLIKIM PËR KOMISION APELIMI NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, nisur nga Urdhëri nr. 8 datë 21.01.2022 “Mbi disa masa për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve” i Rektorit të UART dhe mbështetur në ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” si dhe rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”, kreu II neni 6 pika 1, kreu VI neni 37, miratuar me VSA Nr.19 datë 10.02.2020, me votim të hapur unanimit,

VENDOSI:

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor si dhe hapjen e procedurave për aplikim për Komision Apelimi, në Universitetin e Arteve.
2. Kandidatët për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve vetëkandidohen. Ato e dorëzojnë vetkandidimin pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UART.
3. Kandidatët të cilët aplikojnë për anëtar të Komisionit të Apelitimit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme sipas nenit 37, pika 2:
  - a) Të kenë përvojë pune në mëshimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet me kohë të plotë.
  - b) Të mos jenë të denuar asnjëherë për vepra penale me vendim të formës së prerë.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Sekretarisë së Senatit Akademik është jo më vonë se 7 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekanët e Fakulteteve dhe Sekretaria e Senatit Akademik

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

